



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 25 Prot.

Tiranë, më 24.06 2019

**VENDIM Nr. 168, datë 25.06.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Parkut fotovoltaik me panele diellore" zona e ish përpunimit të naftës, Bashkia Kuçovë*-subjekti "BESTA" sh.p.k. dhe "GLOBAL WORK" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Parkut fotovoltaik me panele diellore" zona e ish përpunimit të naftës, Bashkia Kuçovë*-subjekti "BESTA" sh.p.k. dhe "GLOBAL WORK" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "BESTA" sh.p.k. dhe "GLOBAL WORK" sh.p.k duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtimi i Parkut fotovoltaik me panele diellore" zona e ish përpunimit të naftës, Bashkia Kuçovë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)